


Raport lidhur me projektet zhvillimore dhe Linjën e 10-të Hekurudhore për periudhën Shkurt-Maj 2021

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS, përveç angazhimeve tjera të përditshme në realizimin e detyrave të parapara një vëmendje të posaçme i'a ka përkushtuar edhe projekteve zhvillimore të cilat janë të një rëndësie të veçantë. Projektet zhvillimore të INFRAKOS-it në ekzekutim e sipër gjatë periudhës raportuese janë:

1. Rehabilitimi gjeneral i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)
2. Projekt dizajni preliminar për Linjën e 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Prishtinë – Podujevë – Kufiri me Serbinë)
3. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)

1. Rehabilitimi gjeneral i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 1: (Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)




Gjatë muajit Shkurt - Maj 2021, është zhvilluar një numër i konsideruar i aktiviteteve rreth vazhimit të punëve për rehabilitimin e fazës së parë të Linjës së 10-të hekurudhore në disa fronte pune përgjatë kësaj linje hekurudhore. Edhe pse ka pasur punime të përditshme me dritare pune prej 10 orë si edhe përgjatë kohës me ndërprerje 24 orësh të trafikut dhe krijimi i kushteve ideale për punë megjithatë vëllimi i punëve të realizuara nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar andaj është kërkuar angazhim shumë më i madh i kontraktorit për realizimin e punëve në mënyrë që projekti të kryhet në afatin e paraparë.

Punët e realizuara në këtë periudhë kohore janë kryer në stacionin Hekurudhor të Fushë Kosovës, Miradisë, Lipjanit, Bablakut, Ferizajt dhe në stacionin Hekurudhor të Gurzës. Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe Kontraktori ka bërë edhe dërgimin e materialit (pjesëve të infrastrukturës) përfshirë këtu balastin për shtrirje në binarë, traversat e betonit, gabionet dhe materialit tjetër përforcues për binarët hekurudhor.

Aktivitetet të cilat janë realizuar nga Kontraktori konsistojnë me punët e dheut me gërmime demontime të binarëve dhe të traversave të vjetra, ndërtimin e mureve mbrojtëse, platformave të udhëtarëve në Stacionet Miradi, Lipjan, vend ndaljen në Hashanaj, stacionin Bablak, Gurëz, më pas kanalet e kullimit përgjatë trasesë hekurudhore të shoqëruar me lëshesat të llojit kuti betoni dhe ura betoni, si dhe shtrirjen e trasesë së re hekurudhore me traversa dhe binarë të rinj dhe të salduar në një gjatësi 21 km duke përfshirë linjën kryesore dhe atë dytësore në stacione. Në vijim është bërë prezantimi me fotografi i disa nga punët e kryera gjatë kësaj periudhe :

Punimet përgjatë linjës kryesore në st. 248+ 460 – 248+720
Gërmimi dhe testimi i fondimit



Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës përmirësuese



Punimet në linjën 1 dhe 2 (linja kryesore) në Stacionin e Gurzës në st. 289 + 080 – 289 + 740



Vendosja e shtresës përmirësuese



Testimi i shtresës përmirësuese



Punimet në linjat 2 dhe 3 në Stacionin e Lipjanit në st.261+580 – 262+200
Gërmimi në linjat 2 dhe 3

Testimi në kuotën e gërmimit



Gërmimi për shtresën përmirësuese




Vendosja e shtresës përmirësuese



Punimet përgjatë linjës kryesore në Stacionin e Gurzës



Demontimi dhe largimi i binarëve dhe ballastit ekzistues



Punimet përgjatë linjës kryesore për pjesën Fushe Kosovë – Miradi, st.249+860 – 251+100
Vendosja e shtresës së parë të ballastit

Vendosja e traversave të betonit

Gërmimi dhe testimi në kuotën e fondimit



Vendosja, ngjeshja dhe testimi i shtresës sipërme mbrojtëse



Vendosja e traversave dhe binarëve të Përkohëshëm



Vendosja e shtresës së dytë të ballastit



Linja e përfunduar



Ndërtimi i kanaleve të drenazhës dhe mureve mbrojtëse



Ndërtimi i lëshesave dhe urave betonit





Gjatë gërmimit në shumë lokacione janë hasur kablot optike të prezantuara dhe trajtuara si më poshtë:




Punimet në Platformën 3 në Stacionin e Lipjanit



Deponimi i materialeve



Finalizimi i punimeve ne linjën hapur



Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 2: (Fushë Kosovë – Mitrovicë)

Komisioni i vlerësimit për përzgjedhjen e punë-kryesit për punët ndërtimore faza II (Fushë Kosovë-Mitrovicë) ka vazhduar punën edhe pasi Kompania për të cilën fillimisht ishte përcaktuar është tërhequr nga gara, kështu që puna ka vazhduar me vlerësimin e dy kompanive tjera. Pas një pune intensive KV ka përfunduar punën e vetë të vlerësimit duke e hartuar edhe Draft Raportin e vlerësimit i cili iu është dërguar nëpërmjet platformës elektronike ecepp-ebrd bankës BERZH-it për mos-kundërshtime (No Objection) me rastin e përzgjedhjes së punë-kryesit për rehabilitimin e fazës së dytë të Linjës së 10-të hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë). Ky proces pritet të përfundojë së shpejti duke e bërë publik fituesin dhe duke e pritë kalimin e periudhës ankimore 28, ditësh nga data e publikimit dhe ky proces përmbyllet me nënshkrimin e kontratës.

Sa i përket mbikëqyrjes së punëve për fazën e dytë, komisioni i vlerësimit ka përfunduar punën e vetë duke i respektuar në tërësi të gjitha procedurat e prokurimit të BERZH-it dhe si përfundim ka shpallë fituesin si dhe ka pritë edhe periudhën e ankesës prej 10 ditësh nga data e publikimit e cila tani më ka përfunduar kështu që jemi në përmbyllje të procesit duke e përgatitur kontratën për nënshkrim me fituesin për mbikëqyrjeje të punëve ndërtimore për fazën e dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë) me kompaninë konsulentë Hill International N.V.

Publikimi i tenderit për sinjalizim dhe telekomunikacion për Linjën e 10-të Hekurudhore Faza (1+2): (Hani i Elezit – Fushë Kosovë - Mitrovicë)

Projekt dizajni për rehabilitimin e pajisjeve sinjalo siguruese dhe ato të telekomunikacionit për fazën e parë dhe të dytë të Linjës së 10-të hekurudhore ka përfunduar.

INFRAKOS-i në bashkëpunim me kompaninë mbështetëse Egis Internacional dhe me bankat BERZH dhe BEI-në është në finalizimin e dokumentacionit për publikimin e shprehjes së interesit për përzgjedhjen e kompanisë punë-kryese e cila do të bënë rehabilitimin e pajisjeve SS dhe TK.

Në të njëjtën kohë gjithnjë në bashkëpunim me kompaninë konsulente jemi në përfundim të përgatitjes së dosjes së tenderit edhe për publikimin e shprehjes së interesit për përzgjedhjen e kompanisë mbikëqyrëse për sinjalizim dhe telekom për fazën (1+2).

Që të dyja aktivitetet pritët të lansohen posa të finalizohet kontrata me punë kryesit për punët ndërtimore për fazën e dytë.

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 3: (Mitrovicë – Leshak – Kufiri me Serbinë)

Pas përfundimit të Termave të Referencës dhe komenteve të marra nga Bankat BERZH dhe BEI dhe pasi që IFICO i ka dërguar termat e referencës Konzorciumit IPF 9 – Hill International si dokumente finale WBIF ka kërkuar që konzorciumi i IPF9, të kompletohet dhe të filloj hartimin e projekt dizajnit për fazën e III (Mitrovicë - Leshak). IFICO tanimë

2. Projekt dizajni preliminar për Linjën e 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Prishtinë – Podujevë – Kufiri me Serbinë)

Gjatë kësaj periudhe të viti 2021, aktivitetet e vetme të cilat janë zhvilluar nga Konzorciumit IPF 7 – Hill International, ishin në finalizim të raportit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM) për ta kompletuar dokumentacionin final të projekt dizajnit preliminar për Rehabilitimin Gjeneral të Linjës së 7-të Hekurudhore, dhe se tani mund të themi se edhe ky projekt i kompletimit të dokumentacionit

për shpalljen e shprehjes se interesit tani më mund të konsiderohet si i gatshëm dhe final.

Siç dihet për realizimin e këtij projekti kanë shprehur interesim edhe SHBA-ja, andaj INFRAKOS-i pret rekomandimet nga Ministria e Infrastrukturës për zhvillimet e mëtejme.

3. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)

Njëri ndër projektet e infrastrukturës hekurudhore i cili po ashtu financohet nga grantet e Kornizës Investive të Ballkanit Perëndimor (WBIF) është edhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e linjës hekurudhore (Prishtinë – Fushë Kosovë – Aeroporti i Prishtinës), projekt ky i cili është i një rëndësie të veçantë për lidhjen e aeroportit me hekurudhë.

Vazhdon interesimi i ynë si Infrakos duke kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe zyra e Kryeministrit për Asistencë Zhvillimore/ Energji, Transport & TIK, dhe Ministria e Financave mbështetje për të vazhduar më tutje këtë projekt edhe përkundër se tani Institucionet Ndërkombëtare Financiare BERZH dhe BEI kanë shprehur shqetësim lidhur me arsyeshmërinë ekonomike të investimit në ndërtimin e kësaj linje hekurudhore, andaj institucionit vendimmarrëse të Qeverisë së Kosovës duhet ta trajtojnë këtë çështje ashtu që të merret vendimi përfundimtarë se si do të procedohet më tutje por gjithnjë duke mos hequr dorë nga projekti, por ndoshta të shikohen opsione tjera .